



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, si dhe nenit 20.1 të Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit 01Nr.248/11, dt. 24.11.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR HARTIM TË PLANIT PËR VEPRIM NË MJEDIS

Neni 1

Me këtë vendim merret iniciativa për hartimin e Planit për Veprim në Mjedis në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2013-2018, i cili do të jetë në përputhje me planin e Republikës së Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 2

Kryetari i komunës autorizohet që të formoj grupin punues për hartimin e Planit për Veprim në Mjedis, në të cilin përveç zyrtarëve të komunës, do të përfshihen edhe përfaqësues nga ndërmarrjet për kryerje të shërbimeve publike, përfaqësues të OJQ-ve dhe të komunitetit të biznesit.

Neni 3

Kryetari i komunës autorizohet që të nënshkruaj marrëveshjen e mirëkuptimit me Qendrën Rajonale për Mjedis për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC), si implementues të planit për veprim në mjedis, si dhe projektit i cili do të identifikohet për mbrojtjen e mjedisit në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 4

Kuvendi i komunës me rastin e aprovimit të buxhetit të komunës për vitin 2014 do të planifikoj mjetet buxhetore në fondin për bashkëfinancim me donatorë për implementim të projektit për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2014.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspektime, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN
01 Nr. / Br <u>153/13</u>
Nr. i fq. / Br. sh <u>-1-</u>
Data / Datum <u>27.06.2013</u>
VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "ë" dhe 55 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.06.2013**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT
NR. 19-2/10

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01Nr.19-2/10, dt. 28.01.2010, për formimin e Komitetit për Komunitete, si vijon: në paragrafin 1, pika 7, në vend të Ferki Eminit, duhet të jetë Aziz Emiri, përfaqësues i komunitetit rom.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 152 / 13

Nr. i fq. / Br. sht -1-

Data: / Datum 27.06.2013

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/1202 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.06.2013**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT
NR. 297/12

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01Nr.297/12, dt. 30.10.2012, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon: në paragrafin 1.1., nënpika 2, në vend të Abdulaziz Hoxhës, duhet të jetë Bashkim Spahiu – Komandant i Stacionit Policor në Vushtri, si dhe nënpika 8, në vend të Ferki Emnit, duhet të jetë Imer (Tafil) Shaqiri- përfaqësues i komunitetit rom.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 151/13

Nr. I fq. / Br. sh -1-

Data: / Datum 27.06.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Republika e Kosovës

Bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2013, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore 2014-2016 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 1/2013 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa

